

Bordi i Drejtorëve i KRU “Hidromorava” Sh.A. Gjilan, në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, dhe nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Kodit të Etikës për Ndërmarrje Publike dhe Qeverisjes Korporative, nenit 20, paragrafi 5 të Statutit të KRU “Hidromorava” Sh.A, dhe të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRU “Hidromorava” Sh.A., shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës:

- **Titulli i pozitës:** Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit
 - **I përgjigjet:** Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve
 - **Nr. i ekzekutuesve:** një /1/
 - **Paga:** 1,152.00 € bruto
 - **Orari i plotë:** 40 orë në javë
 - **Vendi i Punës:** Gjilan
 - **Kohëzgjatja e kontratës (Mandati):** 3 vite, me mundësi vazhdimi.
- Shënim:** Vazhdimi i mandatit mund të bëhet me vendim të Bordit të Drejtorëve, pa procedurë të re të rekrutimit publik.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjigjet për të gjitha veprimet financiare të Kompanisë;
- Udhëheqë dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate të mira;
- Menaxhon çështjet financiare të Kompanisë, nën drejtimin dhe mbikëqyerjen e KE-së dhe Komisionit të Auditimit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Bënë mirëmbajtja e llogarisë së ndërmarrjes të azhuruar dhe të saktë;
- Bënë udhëheqjen e të gjitha kontrolleve të brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore;
- Monitoron llogaritë e pagueshme dhe koordinon pagesën e faturave dhe blerjet speciale;
- Rishikon shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmëri me politikat e Kompanisë dhe buxhetin para pagesës së tyre;
- Përgatitë të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit;
- Koordinon funksionet e tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve të pajisjeve si dhe bashkëpunon me Kryeshefin Ekzekutiv dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të ndërmarrjes;
- Menaxhon thesarin e ndërmarrjes, vendos dhe përgatitë buxhetin dhe çfarëdo detyre tjetër financiare të përcaktuar nga Kryeshefi Ekzekutiv apo Bordi i Drejtorëve;
- Përgatitë dhe raporton për gjendjen financiare të ndërmarrjes në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

- Bashkëpunon me auditorin e jashtëm për çështje të auditimit dhe bënë implementimin e rekomandimeve të cilat dalin si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë;
- Obligohet për bashkëpunim të ngushtë me Kryeshefin Ekzekutiv, Drejtorin Komercial, Drejtorin Teknik dhe Menaxherët e Divizioneve;
- Ka për detyrë të nxjerr dhe planifikoj buxhetin dhe të vëzhgojë mospërputhjet;
- Të vëzhgojë/përcjellë qarkullimin e parasë së gatshme dhe transaksionet bankare;
- Udhëheqë dhe kontrollojnë të hyrat nga faturimi dhe mirëmbajtjen e të dhënave të konsumatorëve;
- Raporton të Bordin të Drejtorëve, lidhur me progresin financiar të Kompanisë planet aktuale të biznesit, planet periodike dhe afatgjatë të shpenzimeve dhe aktiviteteve, fluksin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Kërkon, propozon dhe zbaton metoda dhe mënyra për të ndërtuar dhe përmirësuar metodat e punës me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të konsumatorëve;
- Siguron se i gjithë personeli është i informuar me synimet dhe misionin e përbashkët të departamenteve, përkatësisht tërësisë së Kompanisë;
- Merr pjesë në mbledhjet e Komisionit të Auditimit dhe mbledhjet e Menaxhmentit;
- Përgatit të dhënat e Kompanisë për auditim në fund të vitit kalendarik;
- Formon komisionet për regjistrimet e fundvitit;
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së eprorit të tij/saj të drejtpërdrejtë;
- Për punën e tij/saj i raporton dhe i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Përvoja e punës në harmoni me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087 dhe LIGJI Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, (Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit).

Kushtet e veçanta:

- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- Të ketë shkathtësi në të shkruar dhe aftësi të shkëlqyera komunikimi;
- Shkathtësi në planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Të mos jetë nën hetime apo të ketë qenë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës;
- Të ketë njohuri të sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Përparësi ka të jetë kontabilist i certifikuar;
- Kualifikimet e tjera profesionale janë përparësi;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- Njohja e punës me kompjuter – programi Microsoft Office.

Informatë e përgjithshme për Kandidatët lidhur me procedurat e konkurimit
Kandidatët për pozitën e lartëcekur duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Diplomë e universitetit;
- Certifikat për Kontabilist të certifikuar (nëse ka);
- CV-në (jetëpërshkrimi);
- Letër motivimi (jo më shumë se 500 fjalë);
- Dëshmitë për kualifikime tjera profesionale;
- Dëshmitë e përvojës së punës të dëshmuara përmes trustit pensional;
- Deklarata nën betim (e cila mund të shkarkohet në ueb faqen zyrtare);
- Certifikatën (dëshminë) se nuk është nën hetime;
- Kopjen e pasaportës ose të letërnjoftimit (shtetas të Republikës së Kosovës).

Afati i aplikimit është 21 ditë nga dita e shpalljes publike të konkursit në ueb faqen e KRU “Hidromorava”- SH.A, në gazetën ditore, në tabelën e shpalljeve publike të Kompanisë.

Afati i aplikimit është nga data: 01.08.2025 deri më datë: 21.08.2025, në ora 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në email adresën: rekrutimi.hidromorava@yahoo.com

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të njoftohen për vendin, dhe kohën e mbajtjes së intervistës me gojë përmes postës elektronike dhe tabelës së shpalljeve publike të Kompanisë.

Bordi i Drejtorëve
KRU “HIDROMORAVA” SH.A.


z. Habil Zeqiri
U.D. Kryesues i Bordit

